

E-pjesëmarrja përmes qeverisjes së hapur në Kosovë: Sfidat dhe perspektivat

B. Sc. Blend Berisha & Prof. Asoc. Dr. Isak Shabani

*Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike,
blend.berisha3@student.uni-pr.edu*

Zhvillimi dhe futja në përdorim e veglave të ndryshme në fushën e TIK, ka hapur mundësi të reja për përfshirjen e qytetarëve në punën e qeverisë dhe në përgjithësi ka ndryshuar pritshmëritë e publikut rreth asaj se si puna e qeverisë duhet të kryhet. Me krijimin e Direktivës për Qeverisje të Hapur (Open Government Directive) në vitin 2009, qeverisja e hapur është futur në një fazë të re duke u kthyer në agjendë të rëndësishme globale. Në fokusin e qeverisjes së hapur janë tri principe kryesore: transparenca, pjesëmarrja dhe bashkëpunimi ndërmjet qeverisë dhe qytetarëve. Për shkak të zhvillimeve teknologjike si rrjetet sociale, mundësia e shndërrimit të qeverisë në një platformë për pjesëmarrje publike dhe bashkëpunim, është kthyer në temë të rëndësishme diskutimi në shumë vende të botës. Në shumë raste, qeveritë vendosen para një presioni të lartë për të implementuar tri principet e qeverisjes së hapur në një kohë relativisht të shkurtër. Kjo imponon nevojën e lansimit të shumë projekteve në të njëjtën kohë, të cilat nuk është e mundur të mbështeten me resurset dhe kapacitetet në disponim të qeverisë. Kjo çon në dështimin e projekteve, mos-penetrimin e tyre në publik, humbje të besimit të qeveria etj. Për të evituar këtë problematikë, në këtë punim, propozojmë Modelin e Maturitetit për Qeverisjen e Hapur (OGovMatKos). Ky model, i përshtatur për Republikën e Kosovës, përbëhet prej pesë niveleve të maturitetit, të ndërtuara në mënyrë sequenciale, qëllimi i të cilave është minimizimi i rrezikut dhe shfrytëzimi i veglave të TIK për të rritur pjesëmarrjen elektronike. Duke u fokusuar në arritjen e një niveli të maturisë në të njëjtën kohë, qeveria mund të ndërtojë një infrastrukturë efektive dhe kapacitetet për 'qeverisje të hapur' pa e mbingarkuar stafin e saj apo bërë konfuz publikun/qytetarin.